

DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE TAKIM ONLINE PËR BASHKËPUNIMET ME AMBASADËN E HOLANDËS

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare zhvilloi një takim online me Dr. Aida Lahi, Këshilltare për Çështjet Ekonomike pranë Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Tiranë. Në këtë takim u trajtuan çështje të bashkëpunimit midis Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare dhe Ambasadës Holandeze nëpërmjet projekteve në fushën e rritjes së transparencës dhe luftës kundër korrupsionit në marrëdhëniet mes sektorit privat dhe institucioneve publike si dhe përmirësimi i klimës së biznesit.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



RAPORTI I BB: 20% E SIPËRMARRJEVE SHQIPTARE RRI TËN BIZNESIN ONLINE GJATË PANDEMISË

Kriza e COVID-19 ka çuar në një nxitje të madhe drejt dixhitalizimit të ekonomisë shqiptare. Një anketë e Bankës Botërore me Sipërmarrjet për vitin 2020 tregon se 20 % e sipërmarrjeve shqiptare të anketuara ose kanë nisur ose kanë rritur aktivitetin e biznesit online gjatë pandemisë së COVID-19. Thjeshtimi i procedurave të taksave ndërkufitare në veçanti për dorëzimet e vogla si dhe harmonizimi i kuadrit rregullator rajonal nënvizohen nga Banka Botërore si element kyç që duhet të kihet parasysh ndërkohë që edhe inkurajimi i Investimeve të Huaja Direkte që mund të jenë katalizatorë për ekosistemin e-commerce në Shqipëri.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



MARRËVESHJA/ MINISTRI I DIASPORËS DHE IOM BASHKËPUNIM NË PROJEKTET PËR DIASPORËN

Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko dhe Drejtuesja e Zyrës së IOM (Organizata Ndërkombëtare për Migracionin) në Shqipëri znj. Alma Jani kanë firmosur një marrëveshje bashkëpunimi me interesa të përbashkëta për sa i përket promovimit dhe bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve shqiptare që jetojnë jashtë Shqipërisë dhe vendeve pritëse. Fushat e bashkëpunimit mes dy institucioneve do të jenë angazhimi i diasporës për zhvillim në përputhje me politikat e përgjithshme, për zhvillim territorial dhe forcim institucional nëpërmjet transferimit të aftësive dhe dijeve, si dhe angazhimi i diasporës në zhvillimin e vendit nëpërmjet investimeve.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



JAVA NË LAJME

ECURIA E EKONOMISË SHQIPTARE NË RAPORT ME EKONOMITË E VENDEVE FQINJE NË PANDEMI



TURQI / KONSULLATA NË STAMBOLL NIS APLIKIMIN PËR DOKUMENTE BIOMETRIKE



DRAFTI I KQZ/ SHQIPTARËT JASHTË VENDIT REGJISTROHEN ONLINE, VERIFIKIM ME FACE-ID



KURSI I KËMBIMIT

MONEDHA	BLERJE	SHITJE
USD	101.4	102.3
EUR	123	123.7
CHF	113.7	114.8
GBP	137.7	138.7
DKK	16 ⁻²	16.61